

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Asllan Krasniqi duke vendosur lidhur me çështjen juridike kontestimore të paditësit D. C. me seli në fshatin S. Komuna e L., ndaj të të paditurës K.-C. me seli në P. (në prani të të autorizuarit të palës paditëse avokatit S.K. nga L. dhe në mungesë ta palës së paditur), lidhur me mosekzistimin e borxhit në shumën e përgjithshme prej; 18,228.99 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, të datës; 26.06.2018, ndërsa me datën; 02.07.2018 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D.C. me seli në fshatin S. Komuna e L..

I. Vërtetohet pala paditëse D.C. me seli në fshatin S. Komuna e L. nuk i ka borxh palës së paditur K.-C. me seli në P. shumën e përgjithshme prej; 18,228.99 euro për shkak të rikthimit të humbjeve të faturuara me datën; 29.02.2012 sipas shifrës së konsumatorit me numër

II. Detyrohet e paditura që palës paditëse ti paguaj shumën prej; 1.110,20 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në afatin kohor prej shtatë ditëve duke lloagritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim

A r s y e t i m

Paditësi D.C.sh.p.k me seli në L. me datën; 25.08.2016 ka parashtruar pranë kësaj gjykate padinë e saj lidhur me vërtetimin e mosekzistimit të borxhit në shumën prej; 18,228.99 euro, ndaj palës së paditur K.-C. me seli në P. duke kërkuar në të njëjtën kohë nga kjo gjykatë aprovimin e saj si të bazuar, pas administrimit të të gjitha provave relevante të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata me rastin e pranimit të kësaj padie dhe në vazhdimësi ka analizuar, vërtetuar dhe ka konstatuar se ka kompetencë lëndore lidhur me shqyrtimin e çështjes juridike të parashtruar si në petitumin e padisë duke iu referuar dispozitave të nenit 29 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës si dhe nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat të Kosovës.

Gjykata paraprakishtë ka njohtuar me aktvendim për përgjigje në padi palën e paditur, e cila në afatin ligjor prej 7 (shtatë) ditëve konkretisht me datën; 15.09.2015 me rastin e dhënjes së përgjigjes në padi ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e palës paditëse të cekura si në padi duke cituar thënjet se pala paditëse ka keqpërdorur energjinë elektrike duke bërë veprë penale në këtë rast andaj edhe për këtë çështje e paditura ka ushtruar kallëxim penal ndaj palës paditëse dhe lënda është duke u zhvilluar sipas CMS-K/DFE-577/2015 të datës; 30.11.2015 dhe mu për këtë çështje i kanë propozuar gjykatës ndërprerjen e procedurës kontestimore në këtë çështje juridike kontestimore derisa të zgjidhet çështja penale.

Në seancën e mbajtur të datës;26.06.2018 pala paditëse i ka propozuar gjykatës mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor të çështjes në mungesë të palës së paditur pasiqë i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë i njohtuar përmes diktimit në procesverbalin e datës;29.05.2018 për tu paraqitur në këtë seancë,i njëjti nuk është paraqitur dhe mosardhjen e tij në këtë seancë nuk e ka arsyetuar,poashtu gjykata ka njohtuar palën paditëse edhe për mungesën e palës K. të propozuar nga pala e paditur duke u thirrur në mungesë të legjitimitetit pasiv në këtë çështje juridike kontestimore,andaj gjykata duke iu referuar dispozitës së nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së propozimin e palës paditëse e ka aprovuar në tërësi si të bazuar dhe në të njëjtën kohë pasi është njohtuar nga pala paditëse se nuk ka prova tjera shtesë as propozime tjera ka kaluar në procedurën e provave duke i administruar të gjitha shkresat e lëndës të cilat i janë dorëzuar gjykatës nga palët ndërgjyëse.

I autorizuari i palës paditëse ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj duke i propozuar gjykatës aprovimin në tërësi të kërkesëpadisë së palës paditëse pasiqë që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për marrjen e vendimit meritor në këtë çështje juridike kontestimore duke iu referuar shkresave të lëndës të cilat janë administruar në procedurën e provave të gjitha veç e veç.

Në fjalën e tij përfundimtare i autorizuari i palës paditëse i ka propozuar gjykatës aprovimin edhe të shpenzimeve të procedurës kontestimore të cilat konsistojnë në pagesën lidhur me hartimin e padisë në shumën prej;208.00 euro,për pagesën e taksës gjyqësore në shumën prej;91,00 euro si dhe shpenzimet lidhur me përfaqësimin në tri seanca të mbajtura në shumën e përgjithshme prej;811.20 euro (270.40 euro x 3).

Objekt shqyrtimi i kësaj çështje juridike kontestimore ka qenë shqyrtimi i kërkesës së palës paditëse lidhur me vërtetimin e mosekzistimit të borxhit në shumën e përgjithshme prej;18,228.99 euro për shkak të rikthimit të humbjeve të faturuara me datën;29.02.2012 sipas shifrës së konsumatorit me numër 9012396.

Me rastin e administrimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka bërë leximin e tyre duke filluar nga;transaksioni i konsumatorit i lëshuar nga K.-C. për periudhën kohore prej datës;01.01.2012-31.12.2016,kundërshtimi i palës paditëse drejtuar K.-ut sh.a Distribucioni Fe. i datës;15.03.2012,çertifikata e biznesit e palës paditëse,përgjigja në padi,fatura e datës;11.09.2015,aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë dega në Lipjan i datës;03.10.2016,kallëximi penal i datës;25.11.2015.

Me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së palës paditëse gjykata është bazuar në të gjitha shkresat e lëndës të administruara në procedurën e provave duke filluar nga transaksioni i konsumatorit për periudhën kohore prej datës;01.01.2012 deri me datën;31.12.2016,fatura e datës;11.09.2015 e veçanërisht nga aktgjykimi i marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë dega në Lipjan të datës;03.10.2016 nga e cila vërtetohet se pronari i palës paditëse B.K. nga fshati S. Komuna e L. është liruar nga aktakuza.

Pretendimet e palës së paditur lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv në këtë çështje juridike kontestimore gjykata i ka refuzuar në tërësi si të pabazuara për faktet e ditura botërisht se pala e paditur është përgjegjëse për furnizimin me energji elektrike në Kosovë dhe e njëjta me rastin e dhënjes së përgjigjes në padi nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë nga kjo bazë por përkundrazi ka njohtuar gjykatën se për këtë palë ka ngritur kallëximin penal me shifrën CMS-K/DFE/577/2015 të datës;30.11.2015 dhe i ka propozuar gjykatës ndërprerjen e procedurës kontestimore deri në zgjidhjen e çështjes penale,ndërkohë që i ka propozuar gjykatës që të ftohet edhe përfaqësuesi i K.-ut për të vërtetuar lëgjitimitetin pasiv në këtë çështje juridike kontestimore,mirëpo e njëjta seancën e datës;26.06.2018 edhe përkundër faktit se ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt nuk është paraqitur në seancë dhe mosardhjen e tyre në këtë seancë nuk e kanë arsyetuar,ndërsa edhe përfaqësuesi i K.-ut nuk është paraqitur në seancë dhe kjo është vërtetuar nga fletëkthesa e datës;04.06.2018 se i njëjti ka pranuar ftesën me kohë dhe të pranuar në mënyrë të rregullt dhe mosardhjen e tyre në këtë seancë nuk e kanë arsyetuar,andaq gjykata duke iu referuar dispozitës së nenit 76 të LPK-së propozimin e palës së paditur për mungesë të legjitimitetit pasiv e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me analizimin,shqyrtimin,konstatimin dhe çmuarjen e të gjitha provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse është bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LPK-së,ndërsa duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata pas shtjellimit të kësaj çështje juridike ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitat e nenit 76,në dispozitat e nenit 254 paragrafi 1,si dhe në dispozitat e nenit 423 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike

Ek.nr.421/2016 me dt;02.07.2018

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi

UDHËZIME JURIDIKE:Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.